



Aleanca për
Media
Etike

VENDIM Nr.80

Ankuesi: Znj. Mirela Jaupi

Kundër: Joq Albania

Vjegëza e postimit objekt ankimimi:

https://www.instagram.com/p/Czd2IXxtab-/?igshid=MzRIODBiNWF1ZA%3D%3D&img_index=1

Bordi i Aleancës për Media Etike pasi shqyrtoi ankesën,

KONSTATOI

1. Postimi i publikuar nga media në faqen e tyre Instagram ka shkelje etike pasi identifikon fëmijën e mitur.
2. Të dhënat e fëmijës të publikuara si, emri, fotoja, apo edhe Shtëpia e Fëmijës ku ai është dërguar para birësimit e bëjnë të miturin lehtësisht të identifikueshëm.
3. Media nuk duhet të justifikohet me faktin se prindi i ka publikuar vetë në rrjetet sociale fotot e fëmijës. Media ka përgjegjësi publike dhe duhet të mbrojë interesin më të lartë të fëmijëve edhe në rastet kur ata publikohen nga prindërit e tyre.



Aleanca për
Media
Etike

Nenet e shkelura sipas Kodit të Etikës së Gazetarit:

Neni 14. Mbrojtja e Fëmijëve dhe Personave me Aftësi të Kufizuar.

Gazetari duhet të respektojë të gjitha parimet e konfirmuara në Konventat Ndërkombëtare për të Drejtat e Fëmijëve dhe legjislacionin shqiptar mbi të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara.

Mbështetur në këto arsyeime, Bordi,

VENDOSI

T'i sugjerojë medias Joq Albania të fshijë postimin ku është publikuar fëmija i mitur.

Gjithashtu i sugjerohet medias të tregohet e kujdesshme në raste të tjera të ngjashme pasi identifikimi i fëmijëve të mitur përbën jo vetëm shkelje etike por edhe shkelje të ligjit për Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve.

Publikuar më 22 Nëntor 2023